

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) e këshilloi atë, “*Oj Aishe, bëhu e butë, sepse Allahu kur dëshiron të fusë mirësi në një familje i udhëzon të bëhen të butë.*”

Ai gjithashtu tha, “*Nuk gjendet butësia në diçka përveç se e zbuluron atë; dhe nuk mungon butësia në diçka përveç se ajo gjë shëmtohet.*”

modestia

I Dërguari (paqja qoftë mbi të) kishte zakon t'i parandalojë njerëzit nga ngritura në këmbë si shenjë respekti për të. Ai ulej kudo që kishte vend të lirë në një ndejë apo mexhlis dhe kurrë nuk kërkoi një vend më të dalluar apo më të lartë. Ai kurrë nuk veshi ndonjë gjë për ta dalluar veten nga shokët e tij, ose të paraqitet si njeri i rangut më të lartë se ata. Ai kishte zakon të përzipej me të varfërit dhe skamnorët; ai kishte zakon të ulej me më të vjetërit dhe t'i ndihmojë të vejat. Njerëzit të cilët nuk e njihnin atë, nuk mund ta dallonin atë.

Duke iu drejtuar shokëve të tij, ai tha, “*Allahu më ka shpallur që i thitarët e mi duhet të jenë modestë ndaj njëri-tjetrit, që askush askujt të mos i bëjë padrejtësi dhe që askush të mos lavdohet kundruall tjetrit.*”

Aq e madhe ishte modestia e tij saqë kishte frikë se mos do ta adhuronin atë, një privilegj dhe e drejtë që i takon vetëm Allahut,

“*Mos më lavdëroni në të njejtën mënyrë që të krishterët e lavdëruan Isanë, birin e Merjemes. Sepse vërtetë unë nuk jam asgjë më tepër sesa rob dhe i Dërguar i Allahut; Kështu thoni robi dhe i Dërguari i Allahut.*”

burri ideal

Gruaja e dashur e Pejgamberit, Aishja, për burrin e saj fisnik tha, “*Ai gjithmonë më ka ndihmuar në punët e shtëpisë, nganjëherë rregullonte rrobat e tij, riparonte këpucët e tij dhe pastronte dyshemenë. Ai mjetë, mbronte dhe ushqente kafshët e tij si dhe kryente punët e përditshme.*”

Njo vetëm që ishte një burrë i përkushtuar, ai gjithashtu inkurajoj shokët e tij të ndjekin shembullin e tij, “*Më i miri prej jush është ai që është më i miri ndaj familjes së vet, dhe unë jam më i miri ndaj familjes time.*”

“E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: ‘Paqe!’”

Kur'an 25:63

“Dhe çoni jetë të mirë me to (gratë e juaja).”

Kur'an 4:19

shembulli ideal

“Vërtet, ti (O Muhamed) je në një shkallë të lartë të moralit!”

Kur'an 68:4

Tërë ajo që u cek ishte vetëm një paraqitje e shkurtër se si Muhamedi (paqja qoftë mbi të) jetoi jetën e tij. Shembujt e përmendur të mirësisë dhe mëshirës mund të duken si një surprizë për disa njerëz që u është portretizuar gabimisht Islami në media si dhe shtrembërimi i tij i vazhdueshëm.

Është e rëndësishme, kur dikush përpinqet që ta kuptoj fenë islamë, duhet të shkojë drejt në burimet e saj: Kur'ani, dhe thëniet e veprimet e Pejgamebrit Muhamed (paqja qoftë mbi të), dhe se askush nuk duhet gjykuar Islamin bazuar në disa veprime të këqija të disa muslimanëve.

komento nga

jomuslimanët

Mahatma K Gandhi, një lider i madh politik dhe shpirtëror i lëvizjes indiane për pavarësi, theksoi, “*Ishin thjeshtësia e palëkundur, qëndrimi absolut i Pejgamberit, përpikëria për zotimet e tij, përkushtimi intensiv për miqtë dhe pasuesit, guximi, trimëria, besimi absolut në Zotin dhe në misionin e tij që duruan çdo gjë dhe kapërcyen çdo pengesë, e jo shpatat.*”

George Bernard Shaw, dramaturg britanik, deklaroi, “*Bota ka nevojë urgjente për një njeri me mendjen e Muhamedit. Njerëz fetarë në Mesjetë, për shkak të injorancës së tyre dhe paragjykimeve, e kishin parafytuar atë në një mënyrë shumë të errët sa që edhe e kishin konsideruar atë armik të krishterimit. Por pasi kërkova në historinë e këtij njeriu kam gjetur një histori të mahnitshme e të mrekullueshme, dhe kam ardhur në përfundim se ai nuk ishte armik i krishterimit, dhe duhet të quhet ndryshe “Shpëtimtari i Njerëzimit”. Sipas mendimit tim, nëse atij do t'i ishte dhënë kontrolli mbi botën e sotme, ai do t'i zgjidhë problemet tonë dhe do të siguronte paqe e lumturi, gjëra që bota është duke vuajtur për to.*”

Informacion

t 045-633-370

w islamefaevertete.com

e broshurat@gmail.com

I Dërguari Muhamed

(paqja qoftë mbi të)

Duhet të njiheni
me këtë njeri!

kuptimet
themelore

islamefaevertete.com

kush është Muhamedi?

(paqja qoftë mbi të)

*"Ju e kishit
shembullin më të lartë
në të Dërguarin e Allahut,
kuptohet, ai që shpreson në
shpërblimin e Allahut në botën
tjetër, ai që atë shpresë e shqëron
duke e përmendur shumë
shpesh Allahun."*

Kur'an 33:21

Muslimanët besojnë se Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është Pejgamberi i fundit i zinxhirit të gjatë të pejgamberëve të dërguar tek njerëzit me thirrje që t'i binden dhe ta adhurojnë Allahu duke mos i bërë ortak. Disa prej këtyre pejgamberëve janë Ademi, Nuhu, Ibrahim, Ismaili, Is'haku, Jakubi, Jusufi, Musai, Davudi, Sulejmani, dhe Isai (paqja qoftë mbi të gjithë këta).

Sikur që besohet se Musai (paqja qoftë mbi të) është dërguar me Tevratin (libri i shenjtë origjinal i pandryshuar që iu shpall Musait) dhe Isai (paqja qoftë mbi të) me Ungjilin (libri i shenjtë origjinal i pandryshuar - jo versionet e sotme), muslimanët besojnë se Muhamedi (paqja qoftë mbi të) është dërguar me Kur'anin e Shenjtë që të kumtojë se si duhet praktikuar mësimet e tij.

Gruaja e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) Aishja (Allahu qoftë i kënaqr me të) kur është kërkuar nga ajo që ta pëershkruatë Pejgamberin (paqja qoftë mbi të) ajo u përgjigji, "Karakteri (moral) i tij ishte Kur'an", dmth ai me përpikëri të plotë zbatoi mësimet e Kur'anit Famëlartë në jetën e tij të përditshme. Ne do t'ju paraqesim se si Muhamedi (paqja qoftë mbi të) i ktheu mësimet fisnikë në veprime fisnikë.

misioni i mëshirës

Po ashtu edhe për të ftuar njerëzit që ta falin namazin, ta agjerojnë Ramazanin dhe të japin lëmoshë, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) na mësoi se besimi i njeriut në Zotin duhet gjithashtu të pasqyrojë karakterin e tij në raport me njerëzit e tjerë. Ai tha, "Më i miri prej jush është ai që është pajisur me karakterin më të lartë."

Shumë thënie të Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) theksojnë fuqishëm marrëdhëniet mes besimit dhe veprave, p.sh., "Kush e

beson Allahuun dhe Ditën e Gjykimit le t'i bëjë mirë fqiut të tij; kush beson Allahuun dhe Ditën e Gjykimit le të nderojë mysafirin e tij; dhe kush beson Allahuun dhe Ditën e Gjykimit le të flasë mirë ose le të heshtë."

Pejgamberi i fundit Muhamedi (paqja qoftë mbi të) mësoi njerëzit të jenë të mëshirshëm dhe të respektojnë njëri tjetrin, "**Kush nuk mëshiron, nuk mëshirohet.**"

Në një transmetim tjeter, përmendet se disa njerëz i kërkuan Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) që t'i lutet Zotit për t'i ndëshkua jobesimtarët, por ai u përgjigji, "**Unë nuk jam i dërguar si mallkues por jam i dërguar si mëshirë.**"

falja

Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ishte njeriu që falte më së shumti nga të gjithë, ishte më i sjellshmi dhe më i èmbli. Nëse dikush e ofendonte apo i bënte zullum, ai do ta falte, dhe sa më i ashpër që ishte njeriu aq më i durueshëm ishte Pejgamberi (paqja qoftë mbi të). Ishte tejmase i butë dhe falës, posaçërisht kur ishte fuqi apo mundësi për t'u hakmarrë.

Muhamedi (paqja qoftë mbi të) ishte gjithherë përfalje dhe asnjë grimcë krimi apo arrogance nuk mund të gjendej tek ai, ishte under i madh që të ishe i falur nga ai. Ai ishte shembulli më i mirë i faljes dhe i mirësisë, sic përmendet në ajetin vijues të Kur'anit, "**Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!**"

Kur'an 7:199

*"Le t'ua falin
(gabimin) dhe mos t'ua
zënë për të madhe. A nuk
dëshironi që Allahu t'u falë
ju? Allahu falë dhe
mëshiron shumë."*

Kur'an 24:22

barazia

*"E s'ka dyshim se
te Allahu më i ndershmi
ndër ju është ai që më
tepër është ruajtur
(nga të këqijat)." "*

Kur'an 49:13

Me thëniet vijuese, Pejgamberi (paqja qoftë mbi të), i mësoi se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Zotit,

*"Tërë njerëzit janë nga Ademi,
ndërsa Ademi është nga balta. Nuk
ka epërsi të arabit ndaj joarabit, apo të
ziut ndaj të bardhit, përvëçse me devotshmëri."*

*"Allahu nuk shikon në format dhe trupat tuaj, por Ai shikon në
zemrat tuaja dhe në veprat tuaja."*

Një herë një shok i Pejgamberit (paqja qoftë mbi të) e thirri një shok tjetër me emër fyes, "**Biri i një gruaje të zezë!**" Pejgamberi (paqja

qoftë mbi të), u zemërua dhe u përgjigji, "**A e kundërshton atë për shkak të ngjyrës së zezë të nënës së tij? Ti ende ke brenda vetes një pjesë të injorancës nga periudha paraislamike.**"

toleranca

*"Nuk është e
barabartë e mira dhe e
keaja. Andaj, (të keqen) ktheje
në mënyrën më të mirë, se atçherë
ai, me të cilin kishit njëfarë
armiqësie, do të bëhet
mik i afërt."*

Kur'an 41:34

Burimet islame përfshijnë një numër rastesh ku Pejgamberi (paqja qoftë mbi të) ishte mundësinë për të marrë hak mbi ata që e dëmtuan atë, por kurrë nuk e bëri një gjë të tillë.

Ai e mësoi njeriun që të ketë durim përballë të keqes, "**Nuk është i fuqishëm ai që mund njerëzit me fuqinë e tij, por i fuqishëm është ai që përmban veten me rastin e zemërimit.**"

Durimi dhe toleranca nuk do të thotë që muslimani duhet të jetë pasiv dhe të mos e mbrojë veten e tij me rastin e ndonjë sulmi. I Dërguari Muhamed (paqja qoftë mbi të) deklaroi se, "**Mos dëshironi të përballeni me armikun, mirëpo kur të përballeni me të, duhet tëjeni të durueshëm (d.m.th. qëndroni të vendosur në përballje me armikun).**"

butësia

Një shok që i shërbue Muhamedit (paqja qoftë mbi të) ka thënë:
"I kam shërbyer të Dërguarit të Allahu për dhjetë vite; dhe gjatë gjithë asaj kohe, ai kurrë nuk më ka thënë përf diçka që e kisha bëre. **'Pse e ke bërë?' Dhe ai kurrë nuk ka thënë përf diçka që nuk e kisha bëre 'Pse nuk e ke bërë.'**"

Në një rast, gruaja e Pejgamberit (paqja qoftë mbi të), reagoi me zemërim pasi ishte fyer nga një person.

*"Ti ishe i butë
ndaj atyre, ngase Allahu
të dhuroi mëshirë, e sikur
të ishe i vrazhdë e zemëfortë,
ata do shkapërderdheshin
prej teje."*

Kur'an 3:159